
Nuk është vërtetuar nëse ngrohja e motit do ta largojë Virusin Corona

Kohët e sotme, për shkak të mediave sociale, njerëzit kanë vështirësi të dallojnë se cilët lajme që ata lexojnë janë të vërteta dhe se cilët janë të rreme. Përdorimi në rritje i mediave i ofron secilit individ mundësinë për të ndarë mendimet e veta. Edhe pse ne e shohim këtë si diçka pozitive dhe të favorshme, por sa i përket përhapjes së informacionit manipulues, provokues, të rremë dhe mashtrues, situata nuk është shumë e përzemërt!

Për ne kjo është si një luftë kundër gënjeshtrës dhe përpjekja për të arritur "informacion të saktë dhe të besueshëm" është ajo që do ët na ndihmoj neve. Pra,si te kuptojmë nësë një informacion është i vërtet? Për këtë, është e nevojshme të kalojmë pak kohe duke kërkuar të vërteten rreth informacionit, e si ta bëjme këtë?

Para së gjithash marrja e një perspektive kritike, mos shpërndarja e informacionit të pa verifikuar, afrimi i informacionit me një dyshim të shëndetshëm në mediat sociale dhe të kesh një ide mbi burimet e informacionit të arritur janë ndër gjërat që duhet të bëhen brenda fushëveprimit të luftës kundër lajmeve të rreme.

Atëherë unë duke kaluar kohë në media sociale më në sy një fjalim i presidentit të SHBA-ve Donald Trump, ku ai thoshte se ndryshimi i temperaturës të kohës (ngrohja e motit) do të largojë virusin Corona, u interesova, hasa edhe shumë fjalime të tilla ku Trump kishte thënë po të njejtën gjë. Ja dhe disa video per ju: video 1, video 2



Mezashi nga ana e presidentit të SHBA-ve për shkak se është përsëritur disa herë mundëson që ne të bindemi dhe të besojmë në atë që thotë, shaku është ngaqë në këto ditë ne jemi te izoluar, jemi në kerkim të një shprese ku në këtë rast informacioni se "moti i ngrohte do ta luftoj COVID-19" është shumë pozitiv për ne. Por natyrisht unë menjëherë fillova të zhytem në leximin e lajmeve në portale të ndryshme rreth këtij informacioni sepse doja të kuptoja a

është e vertete ajo që thuhet.

Në këtë artikul e gjeta përgjigjen - nationalgeographic.com



NATIONAL GEOGRAPHIC

SCIENCE | CORONAVIRUS COVERAGE

Will warming spring temperatures slow the coronavirus outbreak?

Flu season generally subsides in April and March, but will the coronavirus go with it? Past coronavirus outbreaks can offer clues.

5 MINUTE READ

BY SARAH GIBBENS

PUBLISHED MARCH 6, 2020

WHETHER THE CORONAVIRUS that's quickly spreading around the world will follow the flu season and subside with spring's arrival is unsatisfyingly uncertain, and many scientists say it's too soon to know how the dangerous virus will behave in warmer weather.

Eshtë një shpjegim më i shëndoshë rreth virusit aktual, përshkak se virusi ka ngjajshmëri me viruset që shkaktojnë ftohje mendohet se corona virusi do t'ju nënshtrohet muajve më të ngrohtë sepse këto lloj viruse i referohen si "sezonale", kështu që komentet e presidentit kanë një mbështetje shkencore.

Por është shumë e pasigurt që COVID-19 do të sillet në të njëjtën mënyrë. Ata që studiojnë aktualisht sëmundjen thonë se hulumtimi i tyre është shumë herët për të parashikuar sesi virusi do t'i përgjigjet ndaj ndryshimit të motit.

Sipas OBSH (organizatës botërore shëndetësore) për të parandaluar këtë lloj virusi *rekomandon larjen e duarve shpesh, duke shmangur kontaktin me ata që tregojnë simptoma të tilla si kollitja ose teshtitja, dhe duke kërkuar trajtim nëse janë të sëmurë*.

Autore:

Hana Durmishi, 17 vjeçare